

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 22 SHTATOR 2022

Pa diskutim që kolegët e Partisë Socialiste kanë folur për gjithçka, përveçse për këtë marrëveshje, edhe pse nuk është ndonjë marrëveshje për të cilën ka debat të madh. Marrëveshjen për ndihmat detare, në të cilën Shqipëria aderon pas kaq vitesh, e kemi votuar në komisione dhe pa diskutim që do ta votojmë edhe këtu, si çdo marrëveshje ndërkombëtare. Deri më sot, ndihmat më të mëdha detare, siç u pa para një jave apo pak më shumë, jepen kryesisht për anije, të cilat vijnë nga vende nën embargo, siç ishte anija libiane. Qeveria nuk thotë asnjë fjalë për këtë, sepse jo vetëm nuk ka çfarë të thotë, por e kanë kapur kompanitë, të cilat nuk e lejojnë të hetojë dhe as t'u përmend emrin.

Përmenden vetëm disa punëtorë nga Libia apo nga vendet e Lindjes së Mesme, por nuk thuhet asnjë fjalë se çfarë bëhet me kompanitë shqiptare, asnjë fjalë se cilat janë agjencitë doganore që e kanë përpunuar, asnjë fjalë se ku janë shkarkuar. Kjo është ndihma detare që jep Shqipëria, duke u dhënë kontrabandistëve dhe trafikantëve akses. Ashtu siç e shikoni në lajme, këtë vit në verë janë kapur disa gomone duke trafikuar drogë dhe gjatë gjithë kohës në Itali ka një shqetësim të madh për trafikun që bëhet me çfarëdolloj forme, kryesisht nëpërmjet detit, duke e pasur Shqipërinë vend burimi kryesor për kanabisin dhe tranzit për të gjitha drogat e tjera. Kjo është ndihma detare që ka dhënë Shqipëria deri më sot, kurse prodhimi i hartave me pagesë simbolike është shumë mirë që bëhet.

Përveç deteve dhe humbjes së kontrollit në territor, Shqipëria ka humbur një betejë apo luftë të fortë këto ditë, për të cilën qeveria flet pak. Ky parlament dhe Komisioni i Sigurisë nuk kanë ende informacion për një agresion kibernetik, që është bërë nga një vend armik, sipas qeverisë, pavarësisht se e kemi kërkuar shpesh. Jo se nuk ka informacion, sepse informacionin e kemi tanimë edhe nga burime prestigjioze, siç janë institucionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, FBI-ja dhe një dokument nga Microsoft-i. Në Shqipëri ka ndodhur një ngjarje shumë e

rëndë, që nuk kalohet dot me propagandë. Sulm i vendeve armike ndodh ndaj cilitdo vendi tjetër që është partner dhe aleat.

Një koleg, për turpin e tij, tha pak më parë që ne sulmohemi dhe i kemi këto kosto, sepse jemi partner me Shtetet e Bashkuara. Jo, Shqipëria është me fat që ka partnere Shtetet e Bashkuara, kurse ne kemi rënë se jemi të dobët, se ka korrupsion shteti dhe qeveria, sepse qeveria nuk i ka përdorur miliona euro për sigurinë kibernetike, por i ka përdorur ose për lobim, ose për t'ua dhënë tri kompanive këtu. Ky është problemi. Po ju lexoj vetëm një pjesë, se si ka dështuar gjithë sistemi dhe rekomandimet e FBIsë, të cilat, në fakt, janë tregues të dështimit të të gjithë shtetit shqiptar, ndaj prokuroria duhet të nisë hetime të menjëhershme për të gjetur përgjegjësit. Ka gjetur hallkë të dobët. Katërmbëdhjetë muaj ka qëndruar në sistem hakeri që ka hyrë nga Irani, por që mund të kishte hyrë nga kudo tjetër.

Të mos harrojmë edhe një element tjetër, që hakerimi ka nisur në maj, një muaj pas zgjedhjeve, pasi qeveria ua ka lehtësuar punën me të gjitha të dhënat personale të qytetarëve, që kanë dalë në mënyrë publike, pasi janë përdorur për patronazhimin, duke i vënë të gjitha institucionet shtetërore në shërbim të zyrave elektorale të Partisë Socialiste. Thuhet se antivirusi nuk ka funksionuar siç duhet dhe nuk ka qenë i përditësuar. Hakerat e kanë çaktivizuar dhe për muaj të tërë kjo gjë nuk i ka rënë në sy askujt. Si ka mundësi, që për 14 muaj nuk i ka rënë në sy askujt?

Në mënyrë normale lind pyetja: a ka bashkëpunëtorë, kur jemi në luftë dhe qeveria del e thotë me të madhe se jemi në luftë? Po këtu, ka ndonjë përgjegjës, apo jo? Se dakord jemi, e kemi thënë: çfarë duhet të japë opozita? Na informoni, nëse duhet mbështetje, që t'ju ndihmojmë, me aq sa kemi mundësi ne. Nuk janë përditësuar sistemet e operimit dhe aplikacionet sipas rekomandimeve të kompanive. Pra, kompanitë kanë rekomanduar që të ketë përditësim, ndërsa qeveria nuk e zbaton. Cila është arsyeja? Ka ndonjë përgjigje sot apo nuk ka? "Monitorimi i transferimit të sasive të mëdha të të dhënave nga sistemet, sidomos të atyre me ndërfaqe publike, server-e-maillet". Pra, duken prej muajsh, thotë. Nuk jua themi ne, nuk po e thonë vetëm ekspertët kudo, por e thotë edhe FBI-ja.

Po jep rekomandime. Janë publike, thotë. A ka ndonjë përgjigje qeveria? Apo prapë nuk ka? Apo nuk është shqetësim ky? Merremi me dokumentimin e hartave. Duhet çaktivizuar portat

dhe protokollet e rrjetit, të papërdorura ose të panevojshme. Pra, nuk është bërë as kjo. Nuk janë çaktivizuar apo hequr shërbimet dhe pajisjet e rrjetit, të papërdorura. Nuk janë miratuar parimet dhe arkitektura e besimit zero, duke përfshirë rrjetet dhe funksionet e mikrosegmentimit, për të kufizuar ose bllokuar lëvizjet anësore. Ka edhe pika të tjera të pafundme. Çfarë reagimi ka bërë qeveria, pas këtyre? Ka dalë Edi Rama në korrik dhe ka thënë: kemi qenë nën sulm, por e kemi zbrapsur.

Është marrë me një medie kombëtare, dhe tashmë është konfirmuar se Edi Rama ka prodhuar edhe një herë tjetër një fake news. Ka dalë para se të ikte jashtë, më 17 shtator, në mos gaboj, dhe ka thënë po ashtu, që: nuk kemi asnjë të dhënë sensitive që ka dalë apo që shqetëson shtetin. Po kur nuk kemi asnjë të dhënë sensitive, si reagon prokuroria në mënyrë të menjëhershme, duke thënë: ndaloni publikimin? Do të thotë se këto janë të vërteta, apo jo? Do të thotë se Kryeministri përgënjeshtrohet edhe një herë tjetër. Le pastaj që është përgënjeshtuar nga dokumente të klasifikuara, të cilat kanë dalë në publik, ekzistojnë sot telegram dhe mund t'i marrë kushdo, ekzistojnë edhe në publik po njësoj.

Dhe çfarë tha qeveria në komision? Sigurisht, u përpoq ta kalonte në përgjegjësi personale, sepse e do për luftë të brendshme edhe këtë. A thua se ka dështuar. Po kush është personi, pra, meqenëse është përgjegjësi personale? Sepse ata po kërkojmë, përgjegjësit. Ku kanë shkuar paratë, 195 milionë euro? Ka përgjigje sot apo nuk ka? Si e zgjidh qeveria, nëse del edhe sistemi i të dhënave të kartotekës digjitale të Policisë së Shtetit, ku dalin të gjithë bashkëpunëtorët dhe të gjithë kriminelët? Si e zgjidh qeveria këtë çështje pastaj? Do t'u thotë medieve: mos e publikoni? Pra, kjo është një ndër ngjarjet më të rënda, që kanë ndodhur, ndaj nuk mund të kalojë kështu.

Nuk mund të kalojë edhe kjo pa përgjegjës, duke thënë se çfarë ka ndodhur në vitet '20, pra të hetojë prokuroria sipas atyre që kanë ndodhur në vitet '20. Ju jeni dhjetë vjet në pushtet dhe s'po shkon njeri në dyert e prokurorisë, e hajde të hetojmë pastaj se çfarë ka ndodhur në vitet '20. Ne jemi votuar për të mbajtur përgjegjëse qeverinë dhe ata që paguhen sot me taksat e publikut. Drejtësia të bëjë punën e saj, pa ndërhyrë Kryeministri, pa i dhënë urdhra nga Kongresi i Partisë Socialiste, duke thënë që ne të heqim mbështetjen. Këtë jemi duke thënë. E

kemi dhënë mbështetjen me votë, përveçse me fjalë, gjatë gjithë kohësh, e kemi inkurajuar dhe kemi shkuar, duke i dhënë besim, duke çuar kallëzime penale.

Po nëse nuk ka efikasitet dhe nuk ka hetime të shpejta, pa diskutim që cenohet besimi i publikut. Ne jemi këtu për t'ua thënë. E nëse duhet mbështetje, edhe për t'i mbështetur përsëri. Jo duke kaluar çdo gjë që ndodh në këtë vend, duke i dhënë elementët e një të shkuare, që, pa diskutim, cilido që ka kryer vepra penale në këtë vend, të përballet vetë, por jo me retorikë politike. Tani, shumë shkurt, do t'ju them se më bëri përshtypje dje në një debat, dhe shprehem se si sot Partia Socialiste dhe qeveria po përpiqet ta menaxhojë dhe ku i çon paratë. Janë ngritur pedagogët, studentët, që nuk paguajnë, shtresat në nevojë që nuk marrin paratë që u takojnë dhe që vijnë nga taksapaguesit shqiptarë.

Mesatarisht, çmimet janë rritur pothuajse 30 %, ndërkohë që ju keni propozuar t'u jepni të gjitha shtresave 10 % rritje në çdo nivel. Pra, sot shqiptarët janë 20 % më të varfër me ato që kishin. As që i keni indeksuar dot. Paratë që mbledh shteti më shumë, pothuajse 400 milionë euro, i çon te kompanitë private. E keni kaluar këtu me akt normativ, me ligj. Dje pashë dy prej kompanive oligarke, që marrin tenderë publikë. Njëra kishte deklaruar shtatëmbëdhjetë milionë euro fitim, tjetra njëzet e kusur milionë euro fitim. Njëra quhej "Gjoka", tjetra quhej "Albstar". Kanë marrë para nga ju, nga taksat, nga qeveria.

Pra, atyre që janë të pasur, ju u jepni lekë; atyre që janë të varfër, ju u merrni shpirtin. Ata që janë të pamundur i lini akoma më keq, në mbijetesë, gati për të ikur. Pra, kjo është qeveria sot. Pavarësisht se bën zhurmë, pse nuk dalin prapë? Kanë dalë vetëm dy nga ndërtimet pa leje. Foli Kryeministri për një në qendër të Tiranës. Pse nuk po dalin më ministrat për këto ndërtimet e paligjshme që legalizoni? Të paktën t'i shohim cilat janë, që t'i denoncojmë ne me emra. Cilat janë këto kompani, që vazhdojnë të ndërtojnë? Dolën dy gjithsej. Dolën e folën për dy pallate ministrat. Tani e kanë ndërprerë, sepse logjika dhe gjithë ndërtimi i politikave të kësaj qeverie, është të ndajnë paratë me njëri-tjetrin dhe të godasin të varfrit, të pamundurit dhe shtresën e mesme, që t'i largojnë nga ky vend. Faleminderit!